



Tronditet Skenderaj: Disa persona futen në kafene dhe vrasin një person e plagosin 3 të tjerë



10/08/2023 09:01

f t

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në mesnatën ndërmjet të mërkurës dhe të enjtes.

Disa persona kanë hyrë në një kafiteri në fshatin Runik të Skenderajt, ku ka mbetur i vrarë një person dhe kanë mbetur të plagosur edhe tre të tjerë, shkruan lajmi.net.

Policia ka njoftuar se nga hetimet e para dyshohet se dy persona kanë hyrë në një kafiteri dhe kanë shtënë, ndërsa policia i ka nisur hetimet e në vend ngjarje janë gjetur disa gëzhoja.

Trupi i viktimës është dërguar në obduksion ndërsa të dyshuarit janë në kërkim të policisë.

Njoftimi i plotë:

Rreth orës 01:21, të datës 10 gusht 2023, policia ka marrë informatën për të shtëna me armë zjarri në një kafiteri në fshatin Runikë të Skenderajt. Menjëherë në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet e nevojshme policore dhe ekipi mjekësor.

Bazuar në hetimet fillestare, nga arma e zjarrit lëndime kanë pësuar katër persona, njëri nga të lënduarit viktimë N. L., 39 vjeçar, ka ndërruar jetë në vendngjarje, ndërsa, tre persona të tjerë të lënduar (po ashtu nga arma e zjarrit) janë dërguar për tretman mjekësor në QKUK.

Nga hetimet e para dhe këqyrja e vendit të ngjarjes, dyshohet se dy persona të dyshuar e të maskuar kanë hyrë brenda në kafiteri kanë shtënë me armë dhe janë larguar në drejtim të panjohur. Në cilësi të provave materiale në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar disa gëzhoja.

Gjitha veprimet e ndërmarra policore, janë udhëhequr nga prokurori i rastit i cili ka dalë në vend të ngjarjes ndërsa i njëjti ka autorizuar që trupi i pajetë i viktimës të dërgohet në Institutin e Mjekësisë Ligjore .

Hetuesit e Sektorit Rajonal , janë duke punuar intensivisht për identifikimin dhe arrestimin e kryesit/ve të veprës si dhe zbardhjen e kësaj vepre penale .

Artikuj të ngjashëm



August 15, 2023
Përrjashtohet nga VV asamblisti narko-trafikant që u kap me 11 mijë...




August 15, 2023
Vrasja në kafiteri në Klinë: Dorëzohet në polici Tush Frroku



August 15, 2023
Pritje të gjata në Merdare, Policia del me njoftim të rëndësishëm...



August 15, 2023
"Prishtina" me aksion për shkyqjen e borxhlinjve në Lipjan dhe Shtime:....



August 15, 2023
I arrestuar për drogë me asamblistin e VV-së është edhe reperi...




August 15, 2023
AAK pas arrestimit të Mujecit për drogë: Kurti i ka ardhur fundi

LAJME TË FUNDIT



Përrjashtohet nga VV asamblisti narko-trafikant që u kap...



Vrasja në kafiteri në Klinë: Dorëzohet në polici Tush Frroku



Pritje të gjata në Merdare, Policia del me...



"Prishtina" me aksion për shkyqjen e borxhlinjve në...